



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## INTERVISTA E AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH NË “BUGAJSKI HOUR”

*Regjistruar më 17 maj, transmetuar më 18 maj 2013*

**Bugajski:** Është koha e “karriges së nxehtë” të Bugajskit. I ftuari i sotëm është Eugen Wollfarth, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Faleminderit që pranuat ftesën tonë! Mirëserdhët në emision!

**Wollfarth:** Faleminderit për ftesën! Është kënaqësi!

**Bugajski:** Disa fjalë rreth të ftuarit tonë për shikuesit. Ai ka punuar mbi 25 vjet, më korrigjoni nëse gabohem, për Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë dhe ka përvojë të gjatë në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe pozicionin e Kryetarit të Përfaqësisë Gjermane në Prishtinë dhe Drejtorit të Divizionit në Departamentin Evropian në Berlin. Erdhi në Tiranë, në shtator 2010, si kryetar i OSBE-së, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëserdhët edhe një herë! Kalojmë direkt te pyetjet. Po filloj me një pyetje të përgjithshme për ata shikues, që nuk e kuptojnë çfarë është OSBE-ja. Unë kam punuar herë pas here me OSBE-në për 20 vjet dhe e kam parë të zhvillohet, veçanërisht pjesën që merret me monitorimin e zgjedhjeve. A mund të na bëni një përmbledhje të asaj çka është OSBE-ja, çfarë bën dhe pse është e rëndësishme?

**Wollfarth:** OSBE-ja filloi si një konferencë dhe tani është një organizatë. Si konferencë, ndihmon në gjetjen e kanaleve të dialogut midis Lindjes dhe Perëndimit, vendosjes së paqes, afrimit me njëri-tjetrin dhe përmbushjes së standardeve e të angazhimeve, për të parë zhvillime paqësore, si lirinë, demokracinë dhe një zhvillim të shëndoshë ekonomik. Këto janë zhvilluar me kalimin e kohës. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u vendos në një kohë të vështirë për Shqipërinë, me ftesë të qeverisë, në vitin 1997. Mandati ynë është të ndihmojë Shqipërinë t’i përmbushë këto angazhime, sepse Shqipëria ka dashur dhe vazhdon të dëshirojë të zhvillohet, të bëjë hapa para, të stabilizojë demokracinë dhe të ketë një jetë më të mirë. Ky është roli ynë, të ndihmojmë shqiptarët dhe, meqë ra fjala, përmes një numri të madh shqiptarësh. 75% e stafit tim janë shqiptarë.

**Bugajski:** Sa staf keni në Shqipëri?

**Wollfarth:** Tani jemi 85 vetë. Kemi qenë më shumë, por kemi bërë progres, jemi bërë më eficientë gjatë viteve dhe na kërkohet të jemi më efikas. Stafit është shumë i mirë dhe është e mrekullueshme të punosh me ta, veçanërisht këtu në Shqipëri. Është një vend që ta shpërblen.

**Bugajski:** Si komponent i OSBE-së, ndoshta mund t’u shpjegoni shikuesve tanë diçka për zyrën me seli në Varshavë, me emrin Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, ODIHR. Është ODIHR-i në fakt që monitoron zgjedhjet dhe që dërgon vëzhgues zgjedhor në vende të ndryshme, edhe pse është komponent i OSBE-së. Por unë kam një pyetje shumë specifike për komentet e kryetares të Misionit Vëzhgues të ODIHR-it në Shqipëri, Conny McCormack, e cila tha se ODIHR-i nuk bën vlerësim të zgjedhjeve dhe nuk legjitimon zgjedhjet. Megjithatë, duke qenë këtu dhe duke bërë një deklaratë për zgjedhjet, ODIHR-i kontribuon, në fakt, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe atë kombëtar, për të

legjitimuar apo delegjitimuar zgjedhjet. Bën më shumë se thjesht rekomandime. Është një vullë e rëndësishme miratimi ose mosmiratimi. A jeni dakord?

**Wollfarth:** Misionet e ODIHR-it kushtojnë. Është një punë serioze, sepse vjen nga shtetet që kontribuojnë për OSBE-në, ku përfshihet edhe Shqipëria. Pra, komuniteti ndërkombëtar i mbledhur në OSBE interesohet për Shqipërinë dhe për këtë arsye investon. Puna e ODIHR-it dhe e Prezencës së OSBE-së bazohet te mandatet. Misioni i ODIHR-it ka mandat për të monitoruar zgjedhjet dhe për të dalë në fund të procesit me rekomandime. Ne, si Prezencë e OSBE-së, punojmë me homologët tanë shqiptarë gjatë gjithë kohës dhe asistojmë në reformën zgjedhore. Një reformë e tillë u bë vitin e kaluar. Ajo u bazua në rekomandimet e ODIHR-it pas zgjedhjeve të shkuara parlamentare e vendore. Këto rekomandime përbëjnë një bazë të mirë për progres, bazuar në ngjarjet dhe faktet e vëzhguara në vend. Në to është theksuar disa herë nevoja për vullnet politik, duke filluar nga partitë politike dhe i gjithë sistemi shtetëror. Kjo na çon drejt diçkaje tejet të rëndësishme. Ne, si OSBE dhe ODIHR, si një institucion i pavarur i OSBE-së, ndihmojmë shqiptarët të arrijnë një sistem plotësisht legjitim. Duam që Shqipëria ta marrë vetë në dorë këtë proces, ku ne ndihmojmë. ODIHR-i ka një ndikim të madh stabilizues.

**Bugajski:** Aty ku dua të dal është se deklaratat e OSBE-së, deklaratat e bëra menjëherë pas zgjedhjeve dhe raporti përfundimtar që del javë më vonë, kanë ndikim të rëndësishëm. Shumë analistë, politikëbërës në Uashington e lexojnë dhe vlerësojnë progresin e çdo vendi në lidhje me procesin e demokratizimit, progresin zgjedhor, etj. Po përpiqem të theksoj rëndësinë e OSBE-së, jo vetëm për imazhin e vendit, por edhe për progresin e vendit, si perceptohet në nivel ndërkombëtar. Jeni dakord me këtë?

**Wollfarth:** Po. Do merrja shembullin e katalizatorit. Institucionet shqiptare, partitë politike dhe qytetarët duan demokraci. Kanë një aktivitet demokratik si zgjedhjet, që janë një nga çastet thelbësore në demokraci dhe marrin asistencë. Prania e ndërkombëtarëve me përvojë me zgjedhjet vëzhgon dhe ndihmon personat dhe subjektet e përfshira për të qenë të disiplinuar dhe për t'iu përmbajtur rregullave të veta, sepse të gjitha zgjedhjet këtu janë bazuar në Kushtetutën shqiptare, në Kodin Zgjedhor të Shqipërisë dhe në ligjet e tjera përkatëse, duke përfshirë edhe Kodin Penal, që parashikon ndëshkime të caktuara për veprime të caktuara. Kjo ndihmon sistemin shqiptar të ketë një performancë më të mirë. Kjo është normale në demokraci ende të reja, ku është bërë progres vitet e fundit.

**Bugajski:** Të prekim disa detaje specifike për zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Shqipëri. Sa të rëndësishme janë ato për progresin e Shqipërisë, jo vetëm sa i përket performancës së procesit zgjedhor, por demokratizimit në tërësi? Sipas vlerësimit tuaj, dhe ju e njihni shumë mirë rajonin, Shqipëria ka ecur para, prapa apo ka mbetur në vend sa u përket zgjedhjeve?

**Wollfarth:** Po ecën ngadalë përpara. Do të dëshiroja të ecte më shpejt. Kjo lidhet me vullnetin politik, për të qenë më teknik aty ku nevojitet. Fleta e votimit është drejtkëndore, ka të listuara partitë, vendoset shenja, hidhet në kuti, pa bërë zhurmë. Por këtu ka detaje që të habisin, sepse kur je i drejtpërdrejtë dhe nuk do të hysh nga dera e pasme, përdor letër të thjeshtë. Këtu është e stilit të kartëmonedhave. Nuk është nevoja për vula në anën e pasme, etj., etj.. Sistemi këtu është i koklavitur. Sa më i koklavitur të jetë sistemi, aq më i lartë është marzhi i gabimit. Jam munduar të përcjell shpesh herë mesazhin “sa më thjesht aq më mirë”. Lërinë zgjedhësit të votojnë. Rezultati është në duart e tyre. Ai duhet të jetë një fotografi e vullnetit të shqiptarëve në ditën e zgjedhjeve, një fotografi e pashtrëmbëruar, pa filtër ngjyre,

e pazmadhuar. Duhet të jetë fotografia e plotë dhe e njëmendtë e të gjithë atyre që u drejtohen qendrave të votimit.

**Bugajski:** Moto apo masa ka qenë gjithmonë, dhe unë kam qenë i pranishëm në Misionet e OSBE-së, veçanërisht në vendet e ish-Jugosllavisë dhe në pjesë të tjera të Evropës Lindore, a ishin zgjedhjet të lira dhe të ndershme? Kjo është pyetja e parë, pyetja e madhe që do bëhej. Sigurisht, varet si e kupton 'të lira dhe të ndershme' dhe ndonjëherë thoshim se ishin mjaft të lira, por jo edhe aq të ndershme. Sa i përket progresit të Shqipërisë deri tani, nuk kemi pasur zgjedhje klinikisht të shëndosha, me fjalë të tjera, deri tani nuk mund të thuhet se kanë qenë plotësisht të lira e të ndershme. Çfarë ju bën të mendoni se këto zgjedhje do të jenë ndryshe nga herët e tjera?

**Wollfarth:** Për mua dhe për shumë të tjerë, elementi më i rëndësishëm i zgjedhjeve të lira është që të mos kontestohen. Kjo është themelore. Pjesa e ndershmërisë është shumë më komplekse. Do të filloja me sistemin. Kur je parti e vogël, a do ta shihni të drejtë një sistem që u jep më tepër përparësi partive të mëdha? Kjo është vetëm një nga komplikimet. Nuk ka vetëm një përgjigje të saktë, sepse demokracia lejon një larmi qasjesh: sistem maxhoritar, si në Angli, apo sistem shumë të balancuar në vende si Gjermania, ku është gjithashtu i koklavitur, sepse balancimi kërkon llogaritje që qytetari i thjeshtë nuk i kupton, ku futet edhe Gjykata Kushtetuese. Pra, ka shumë qasje. E rëndësishme është që gjithçka të kalojnë përmes sistemit që konsiderohet i ligjshëm në atë vend. Shqipëria ka sistemin e vet, që duhet ta respektojë dhe ta pranojë. Nëse partitë shqiptare shohin se ka nevojë për ndryshim, ato duhet të bëjnë këtë në dobi të qytetarëve, sepse rezultati fundor duhet të jetë një qeveri që sjell progres e të dijë të përfshijë edhe opozitën. Kjo pasi, në Shqipëri, për të gjitha pjesët kryesore të procesit të reformës, nevojitet një shumicë prej 60%, që deri më sot asnjë kamp politik nuk e ka arritur. Prandaj, bashkimi në ekipin "Shqipëria" është po aq i rëndësishëm sa edhe konkurrimi. Ky është roli i partive politike, të dalin me ide më të mira, me program më të mirë, të jenë më bindëse për qytetarët, që ata të kenë përshtypjen dhe bindjen në ditën e votimit se po votojnë për një të ardhme më të mirë. Më pyetët ç' do të thonë këto zgjedhje për shqiptarët. Ju them se janë shumë të rëndësishme dhe vendimtare për të ardhmen. Organizata shumë të rëndësishme ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian, e kanë bërë të qartë rëndësinë e zgjedhjeve për integrimin e ardhshëm të Shqipërisë.

**Bugajski:** Për progresin e Shqipërisë drejt marrjes së statusit të vendit kandidat, etj.?

**Wollfarth:** Po.

**Bugajski:** Pra këto janë zgjedhjet kyçe, ato që do shënojnë një hap të rëndësishëm?

**Wollfarth:** Po.

**Bugajski:** Më lejoni t'ju pyes nëse i druheni ndonjë mashtrimi apo manipulimi, që mund ta bëjë të pavlefshëm votimin. E kam dëgjuar këtë nga disa njerëz. Di se në shumë vende ka pasur dyshime se disa elementë të votimit janë shtrembëruar apo që numërimi nuk është bërë siç duhet. A mund të ndodhë diçka e tillë në këto zgjedhjeve?

**Wollfarth:** Duke parë zhvillimin e gjërave, jo. Ka pjesëmarrje të komisionerëve të të gjitha kampeve politike në qarqe dhe në qendrat e numërimit, të cilët ushtrojnë kontroll të përbashkët. Kjo është shumë e rëndësishme për të qenë korrekt me numërimin. Numërimi në të kaluarën ka qenë korrekt. Një marzh i vogël gabimi është gjithmonë i mundshëm dhe i

pranueshëm. Kjo ndodh edhe në demokracitë e pjekura. Këtu sistemi është provë e mjaftueshme për të pasur numërim të mirë. Kur komisionerët u përmbahen rregullave dhe ushtrojnë kontroll të përbashkët në qendrat e numërimit, atëherë nuk shoh ndonjë rrezik. Është mirë të ketë kontroll të dyfishtë. E mirëpres, si shumë të tjerë, që ka dhe masa të tjera si përfshirja e publikut, me kamera që tregojnë fletët e votimit në ekran. E gjithë kjo ndihmon në krijimin e besimit te publiku se numërimi është korrekt. Kjo kërkon kontributin e të gjitha palëve.

**Bugajski:** A do të ketë numërim paralel të votave?

**Wollfarth:** Doni të thoni që publiku të bëjë llogaritjet e veta..

**Bugajski:** Le të themi që OJF-të të kenë akses në tabelat e rezultateve, për të kontrolluar që shifrat zyrtare që kalojnë në nivelin tjetër të janë të sakta.

**Wollfarth:** Kam përshtypjen se mund të jetë e ngjashme si me zgjedhjet e fundit vendore. Ata i vëzhguan nga afër, nga një pozicion ku mund të bënë diçka që dukej si një numërim paralel. Nuk tingëllon bukur, por për të kontrolluar dyfish...

**Bugajski:** Por kjo krijon besimin e qytetarëve...

**Wollfarth:** Po. Dhe dërgon mesazhin se numërimi po vëzhgohet nga afër. Është si polici në rrugë: ka më pak gjasa ta shkelësh semaforin kur ka një polic. Ndhmon për t'iu përmbajtur më mirë rregullave. Respektimi i rregullave, i shtetit të së drejtës, duke filluar në fakt nga zgjedhjet, është një element kyç.

**Bugajski:** Pak më vonë do t'ju bëj një pyetje më specifike për Komisionin Qendror Zgjedhor, që është shndërruar në çështjen kryesore. Tani, a mund të na thoni çfarë lloj ekspertize dhe këshille u ka dhënë Misioni juaj institucioneve të ndryshme zgjedhore këtu, sepse një nga rolet e OSBE-së është që të përçojë përvojën që OSBE-ja ka pasur gjatë 20-30 viteve të fundit, veçanërisht me monitorimin e zgjedhjeve, për të ndihmuar në zhvillimin e një procesi zgjedhor pa probleme, efektiv dhe legjitim. Çfarë këshille u ka dhënë OSBE-ja institucioneve në Shqipëri?

**Wollfarth:** Momenti kyç ishte të bindnim partitë politike të ulëshin dhe të fillonin negociatat dhe diskutimet për reformën e Kodit Zgjedhor. Siç e dini, kjo zgjati shumë. Pati një përpjekje të parë në tetor 2010, por u desh më shumë se një vit për t'u ulur më në fund, edhe në nivel deputetësh e ekspertësh. OSBE-ja dha këshilla, në bazë të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011. Këto çështje u diskutuan midis interlokutorëve shqiptarë. Disa pika, si çështja gjinore, nuk u reflektuan plotësisht. Pozicioni i grave u përmirësua, por jo aq sa kishim dëshiruar. Një nga rrjedhojat, siç e keni parë, ishte që KQZ-ja ndëshkoi disa parti për mospërmbushjen e kuotës gjinore prej 30%, për gratë, por në një rast edhe për burrat, sepse vlen për të dyja gjinitë. Pati edhe çështje për të cilat erdhën ekspertë të tjerë të ODIHR-it, si për numërimin elektronik, që synohet të testohet në Fier dhe për leximin elektronik të kartave të identitetit në Tiranë, dy risi të reformës së Kodit Zgjedhor.

**Bugajski:** Sa i rëndësishëm është roli i OJF-ve shqiptare në procesin zgjedhor, sa i takon monitorimit apo nxitjes së qytetarëve për të votuar?

**Wollfarth:** Ne, së bashku me partnerët e tjerë, e vlerësojmë faktin që OJF-të shqiptare janë aktive. Këtu jemi në Shqipëri dhe ku ka më mirë se sa vetë që shqiptarët të angazhohen për zhvillimin e tyre demokratik. Më mirë nuk bëhet. E vlerësoj shumë këtë dhe kam mbetur mjaft i kënaqur nga mënyra se si këta vëzhgues u pritën pas zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës. Ishte një sinjal shumë nxitës për të treguar që puna e tyre vlerësohet edhe në institucionet më të larta. Jam i lumtur kur ne jemi thjesht një ndihmë më shumë. Kjo është mbase më e mira.

**Bugajski:** A mund të thoni se përfshirja është më e madhe tani se sa në zgjedhjet e mëparshme?

**Wollfarth:** OJF-të bëhen më aktive dhe më konstruktive dhe ky është gjithashtu një element i rëndësishëm. Po aq sa janë të rëndësishme kritikrat, pozitive apo negative, janë të rëndësishme edhe propozimet për zgjidhjen e çështjeve, sfidave, apo problemeve. Është shumë e rëndësishme dhe edhe OJF-të mund ta bëjnë këtë.

**Bugajski:** Po ju pyes specifikisht. Ka pasur raporte nga OSBE-ja dhe nga struktura të tjera, që shprehin shqetësime serioze në lidhje me procesin zgjedhor. Për shembull çështja e mjedisit politik të politizuar, diçka që është theksuar nga BE-ja dhe që ka pasur ndikim të madh negativ. Ka pasur ndikim negativ për demokratizimin, për funksionimin e Parlamentit. A do të ketë kjo një ndikim negativ te zgjedhjet?

**Wollfarth:** Gjuha e ashpër e përdorur nga aktorët kryesorë politik, ose të paktën nga shumë prej tyre, duke përfshirë kryetarët e partive të mëdha, nuk ndihmon për të përcjellë një imazh inkurajues që të tregojë se ata janë të aftë të punojnë së bashku. Dua t'ju kujtoj se dhe pas ditës së zgjedhjeve do të nevojiten 60% në mënyrë që të ecet përpara me procesin e reformave. Ne jemi këtu për të dhënë ndihmë që të shkohet drejt procesit të reformave dhe se çfarë të bëhet me këtë proces. Sipas deklaratave të të gjithë aktorëve kryesorë, Shqipëria kërkon të integrohet në strukturat evropiane, të cilat përfshijnë Bashkimin Evropian. Prandaj këto hapa drejt reformave janë të nevojshme. Si po i rrisni mundësinë për të arritur një shumicë prej 60%? Duke sulmuar dhe njoollur gjatë gjithë kohës palën tjetër politike?! Mbase jo. Me shumë gjasa jo. Kjo nuk çon në atë mjedis konstruktiv që duam të shikojmë. I gjithë vendi duhet të jetë i bashkuar. Partitë politike në nivelin e lartë dhe partitë e mëdha duhet të kenë një synim dhe të konkurrojnë në mënyrë të civilizuar, me ide të mira, me programe të mira, me sjellje bindëse. Fjalët e gabuara nuk i bën kujt përshtypje. Ato i largojnë njerëzit dhe nuk ndihmojnë në krijimin e besimit. Gjithashtu, kjo i përcjell një imazh shumë negativ botës, sepse ndonëse zgjedhjet mbahen këtu valët e tyre shkojnë larg. Ato mund të arrijnë edhe te investitorë të interesuar, të cilët, kur shohin çrregullime, mund bëjnë zgjedhje tjetër. Prandaj, do të përsërisja diçka që duhet të jetë shumë e qartë. Me fundin e diktaturës, Shqipëria nuk është e vetme në planet. Ajo dëshiron të integrohet, prandaj duhet gjithashtu të marrë parasysh se çfarë imazhi krijon me veprimet e saj. Imazhin e një sjelljeje të mirë apo të keqe?

**Bugajski:** Mendoj se jeni dakord se do të ishte i dobishme një debat i nivelit më të lartë të drejtuesve të dy partive kryesore në mënyrë të civilizuar. I kam ftuar në emisionin tim këtu, por nuk mendoj se duan aktualisht të ulen e të flasin. Kjo është ajo që bëjmë në Amerikë. Sado baltë të hidhet, vjen një moment kur duhet t'u tregosh votuesve se çfarë përfaqëson dhe ku ndryshon kundërshtari. A mendoni se një gjë e tillë do të ishte e dobishme këtu?

**Wollfarth:** Absolutisht po. Bëtë shumë mirë që ua dërguat ftesën. Nuk më habit shumë, por më vjen edhe mua keq që nuk e kanë pranuar ftesën, sepse do të kishte qenë mundësi e mirë për të treguar se ku ndryshojnë mes tyre. Më e rëndësishmja në këtë fazë është të tregosh vullnet për të ecur përpara dhe për t'u bashkuar kur bëhet fjalë për të ardhmen e Shqipërisë.

**Bugajski:** Si dhe vullnetin për të bashkëpunuar pas zgjedhjeve për të miratuar legjislacionin e rëndësishëm për të çuar përpara procesin e reformave. Kjo është absolutisht një pikë kyçe. Më lejoni t'ju bëj një pyetje tjetër. Sipas informacionit që keni, a ka pasur ndonjë presion ndaj votuesve apo ndonjë keqpërdorim të fondeve qeveritare gjatë kësaj fushate? Kur them presion ndaj votuesve, dua të them blerjen e votuesve. A është raportuar ndonjë gjë e tillë?

**Wollfarth:** Ankesa ka. Ne shqyrtojmë ato që lidhen me shpërdorimin e fondeve publike për fushatë. Kemi dëgjuar raportime dhe pretendime në nivelin qendror e vendor dhe ne shohim nëse merren masa për kufizimin apo ndalimin e këtij fenomeni. Kjo është pjesë e vëzhgimit. Legjislacioni shqiptar e ndalon qartësisht përdorimin e mjeteve publike për fushata dhe kjo duhet të respektohet nga të gjithë ata që bëjnë fushatë.

**Bugajski:** E di që është shumë e vështirë për qeverinë, kur del në televizor, të bëjë dallimin se çfarë të raportojnë rreth qeverisë dhe çfarë raportojnë rreth partisë. Është gjithmonë një zonë e mjegullt.

**Wollfarth:** Patjetër që ODIHR-i, që mbërriti në fillim të kësaj jave, do të vëzhgojë edhe këtë pjesë dhe jam i bindur që do të jetë një element i raportit të tyre.

**Bugajski:** Kalojmë te një nga ato pyetjet e nxehta. Në Uashington, ne që ndjekim nga afër zhvillimet në Shqipëri, dëgjojmë gjatë gjithë kohës temën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe problemet me të. Siç e dimë, KQZ-ja nuk i ka për momentin të shtatë anëtarët. Së pari, a do të thoshit që procedurat për zëvendësimin e anëtarëve të KQZ-së ishin të ligjshme?

**Wollfarth:** Pati vetëm një zëvendësim nga ana e qeverisë. U hoq një anëtar në një mënyrë që ende ka nevojë për analizë të mëtejshme, në baza ligjore jo aq të qarta. Por, pikësepari, ia lë palës shqiptare që ta zgjidhë këtë. Kjo krijoi disa valë që e çoi anën tjetër drejt disa dorëheqjeve, që erdhën gjithashtu në hapa të ndryshme, për arsye të ndryshme dhe mbase edhe bazuar në sfonde të ndryshme. Ajo që mbetet është një Komision Qendror i Zgjedhjeve i cunguar, me vetëm katër nga shtatë anëtarë. Për vendimet teknike dhe sipas legjislacionit, ai është funksional. Por aspekti i ligjshmërisë është vetëm një gjë. Është shumë e rëndësishme të ketë besueshmëri maksimale, e cila është sigurisht e kufizuar kur nuk ka anëtarë të emëruar nga opozita.

**Bugajski:** Kjo ishte pyetja ime e radhës. Sa i besueshëm është tani Komisioni i Zgjedhjeve? A e ka humbur besueshmërinë dhe legjitimitetin?

**Wollfarth:** Nuk është aq i fortë dhe nuk mund të jetë aq bindës sa më parë. Tre anëtarët e mbetur plus anëtari i ri, bëjnë maksimumin për të vijuar përgatitjet teknike që përfshijnë një testim të brendshëm kohët e fundit të lexuesve të kartave të identitetit. Të gjithë hapat që janë të rëndësishëm për të ndjekur Kodin dhe për t'u përgatitur për këto zgjedhje. Kjo është e rëndësishme, është një shërbim i madh dhe shumë i nevojshëm për vendin. Ndjej keqardhje për anëtarët që kanë mbetur, duke filluar nga kryetarja, zonja Lleshi. Duket sikur ata kritikohen shumë dhe prapëseprapë duhet të punojnë me shumë energji për të bërë përgatitjet

për këto zgjedhje. Do të ngurroja të futem në detajet që çuan në heqjen e z. Muho të LSI-së, por mund të them se ishte një lëvizje surprizë, e cila ende ka nevojë për shpjegime në lidhje me bazën ligjore. Shpjegime që nuk kanë ardhur. Këtu vihet në pikëpyetje legjitimiteti. Vihet në pikëpyetje edhe vullneti politik, të cilit i mëshoi edhe ODIHR-i pas zgjedhjeve të fundit. Ku është vullneti politik i palës tjetër? Mos jemi në një skenar dhëmb për dhëmb? A janë PS-ja dhe LSI-ja tani të përjashtuara nga zbatimi i ligjit dhe detyrimet e privilegjet që kanë partitë, vetëm sepse u hodh një hap tjetër i diskutueshëm?! A do të thotë kjo që nga ana tjetër të tregohesh destruktiv për të rritur legjitimitetin?! E lë në dorë të drejtuesve politikë. Përsëri, u bëj thirrje t'u përmbahen angazhimeve. Ata thonë se janë të angazhuar për interesat e popullit shqiptar, por duhet t'i përmbushin ato. Kur janë të pakënaqur me elemente të vendimeve apo procedurave të caktuara, mund të ngrenë zërin. Edhe në Shqipëri është e mundur të ngresh zërin pa përdorur fjalor të papërshtatshëm. Dhe qytetarët, mund t'ju siguroj nga informacionet që marrim, do ta mirëprisnin këtë, sepse ata duan të kenë zgjedhje, duan të ndërtojnë besim te sistemi dhe kjo bëhet më mirë kur të gjitha kampet politike përfaqësohen në mënyrë aktive në institucione kyçe, siç është KQZ-ja, në përgatitjen e zgjedhjeve të përgjithshme. Këto janë të meta për të cilat nuk do reshtja së ngrituri zërin. Vërtet nuk arrij ta kuptoj pse u zgjodh kjo taktikë si opsion i mirë. Nuk është opsion i mirë.

**Bugajski:** E keni fjalën për heqjen e tre anëtarëve apo si për zëvendësimin...

**Wollfarth:** Lënia e një boshllëku për një kohë kaq të gjatë kaq afër zgjedhjeve.

**Bugajski:** A mendoni, sikurse thotë opozita, që e gjithë KQZ-ja ka nevojë të riformohet? Me fjalë të tjera, a ka nevojë të nisë nga fillimi?

**Wollfarth:** Kjo do të kërkonte shpjegime të mëtejshme se përse duhet bërë një gjë e tillë kaq afër zgjedhjeve. Meqë ra fjala, znj. Lleshi dhe z. Biba, i cili dha dorëheqjen, kanë bërë një përpjekje të madhe, një punë shumë të mirë. Kanë punuar mirë e bukur bashkë, të mbështetur nga ekipi. Pra shumë, në mos e gjitha, e asaj që po shohim, mund të ishte shmangur.

**Bugajski:** Pra, ju do t'ua vinit fajin të dyja palëve për këtë problem me KQZ-në?

**Wollfarth:** Po, absolutisht. Të dyja palët, me të meta, me veprime jo në interes të popullit, për arsye shumë të ndryshme, mbi baza ligjore shumë të ndryshme, por me të njëjtin përfundim: dëmtimin e një organi që duhet të jetë teknik dhe plotësisht funksional para zgjedhjeve të përgjithshme.

**Bugajski:** A mendoni se me trysni ndërkombëtare dhe me ndërgjegjësimin që zgjedhjet, në një farë mënyre, do të humbnin legjitimitetin, palët do të vihen nën trysni për të gjetur gjuhën e përbashkët e për ta zgjidhur si përfundim këtë problem në KQZ?

**Wollfarth:** Sa i për përkufizimit të trysnisë, do të thosha...

**Bugajski:** Këshillë, ndoshta, do të ishte një fjalë më e përshtatshme.

**Wollfarth:** Këshillë po, por ndoshta jo trysni... Ky është një vend i lirë, një vend sovran. Është një vend që mund të vendosë për shpejtësinë e reformave të tij, që ndikon në shpejtësinë e procesit të integritimit evropian. Ndaj, përse t'i shtysh shqiptarët?! Nëse nuk duan të lëvizin, në rregull. Por është vendim që u takon atyre. Liria është punë e ngatërruar.

Unë jam tifoz i lirisë. S'ka rëndësi nëse e përdorimin fjalën në gjermanisht apo latinisht. Është shumë e rëndësishme dhe përfshin edhe lirinë për të dështuar dhe për të bërë gabime.

**Bugajski:** Edhe lirinë për të mos bërë asgjë.

**Wollfarth:** Por nëse kjo është në të mirën e popullit shqiptar, tani në zgjedhjet e 23 Qershorit, zgjedhësit do të kenë rastin t'i japin një përgjigje kësaj.

**Bugajski:** Më lejoni t'ju bëj disa pyetje të tjera rreth problemeve të mundshme. Fushata ka nisur zyrtarisht tani dhe sigurisht që mbulohet shumë nga media. A do të thoshit se atmosfera mediatike është shumë e polarizuar dhe ka prirjen të favorizojë interesa të caktuar politike? Jo ky kanal sigurisht...

**Wollfarth:** Ndonjëherë mund të shihet se cilit kamp i përkasin, për nga sfondi. Do të doja të kishte një ndarje më të madhe midis fakteve dhe opinioneve. Të dyja përbëjnë një medium të mirë, por sidomos një gazetë të mirë. Unë personalisht do të dëshiroja, bashkë me shumë të tjerë, të kishim më shumë analizë të punës programatike që kemi përpara. Çfarë duhet bërë në aspektin social, për arsimin. Ka shumë diskutime gjithashtu rreth përmirësimit të infrastrukturës. Të gjitha këto janë çështje shumë të rëndësishme, por që nuk marrin vëmendjen e duhur në këtë atmosferë të ndezur, ku shpeshherë ka gjuhë dhe shkëmbime tepër të ashpra. Duhet bërë më shumë në aspektin konkret, çfarë e ndihmon Shqipërinë që të ndërtojë një të ardhme edhe më të mirë. Ka pasur përparim të madh, por duhet bërë më shumë, duhen hapur më shumë vende pune. Duhet përcaktuar si mund të arrihet kjo në këtë mjedis konkurrues. Evropa është shumë konkurruese, ka shumë tregje. Nuk mund të flasësh më as për sektorë të specializuar sepse thuajse çdo nevojë duket e plotësuar. Pra duhet të jesh vërtet i aftë në bërjen e punës, për të gjetur specialitetin tënd dhe kjo bëhet edhe përmes programeve të mira të partive që ndihmojnë të shihet shteti i së drejtës, për të pasur një sistem gjyqësor më të mirë, të gjitha këto. Janë çështje të vërteta. Për të mos folur pastaj për korrupsionin, një nga të këqijat që qartas duhet të zvogëlohet këtu, apo trafikimi, lloje të ndryshme trafikimi. Këto janë çështje të vështira që duhet të trajtohen bindshëm në të ardhmen.

**Bugajski:** Një nga problemet, për shumë vjet që kur kam ardhur në Shqipëri, janë listat e zgjedhësve, nëse janë të plota, nëse mungojnë emra. Kam pasur ankesa nga të dyja palët, nga kushdo që humbet, që ka pasur diçka jo në rregull në listën e zgjedhësve. Si është situata tani? A ka ndonjë parregullsi të madhe?

**Wollfarth:** Duket se nuk ka parregullsi të mëdha në këtë kohë, por mund ta kuptoj përse bëhet kjo pyetje. Ne gjithashtu e shohim këtë si një punë në vazhdim. Kodi Zgjedhor u mundëson shqiptarëve që jetojnë jashtë shtetit të votojnë dhe ata, në shumicën e rasteve, rezultojnë ende në vendet ku kanë banuar më parë dhe shumë prej tyre kanë banesa të panjohura. Kjo, sigurisht, ndërkohë që është një detyrim ligjor, nga ana tjetër ngre pikëpyetje se çfarë sjell. Sepse vetëm një numër i vogël, jo të gjithë, do të kenë mundësi të udhëtojnë për në Shqipëri ditën e zgjedhjeve dhe kjo bën gjithashtu që shifrat e pjesëmarrjes të mbeten më të vogla sesa mund të jenë.

**Bugajski:** Mua më duket tragjedi që ndër kaq shumë shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, sa prej tyre mund të gjejnë kohën që të vijnë këtu thjesht për të votuar? Është problem, është diçka që duhet të ishte parë dhe zgjidhur. A luan një rol OSBE-ja në këtë? Të përpiqet të



mundësojë misionet shqiptare jashtë vendit që zgjedhësit të shkojnë qoftë në Athinë, Uashington, Berlin?

**Wollfarth:** Nëse do të na ftonin për të dhënë këshilla në këtë fushë po, por kjo është gjithashtu çështje buxheti. Ndërsa mund të duket e dëshirueshme, Shqipëria ka bërë përpjekje shumë të mira dhe të mëdha dhe kushton para që të ngresh ambasada jashtë vendit, por ky nuk është një vend shumë i madh. Është një vend i bukur, por relativisht i vogël, me një buxhet shteti jo aq të madh. Duhet të jetë në gjendje që t'i përballojë gjithë këto shpenzime dhe infrastruktura, në formën tradicionale, si për një shtet të madh, nuk është ende gati. Mbase përmes bashkëpunimit me një vend të rajonit kjo mund të jetë e realizueshme në të ardhmen, por aktualisht shoh arsye të forta përse nuk është zhvilluar më tej.

**Bugajski:** Diçka që duhet parë më nga afër.

**Wollfarth:** Po, mundësia financiare duhet marrë parasysh gjithashtu.

**Bugajski:** Megjithatë në këtë epokë votimi elektronik, kompjuterizimi, e kështu me radhë, mund të mendohej se nuk do të ishte aq e kushtueshme krahasuar me paraqitjen fizike në kutinë e votimit si në kohët e vjetra.

**Wollfarth:** Ndoshta, ndoshta. Demokracia ofron mundësi të shumta. Nëse mund të shtoj, personalisht në këtë drejtim unë mbetem ende shumë tradicional. Më pëlqen të shkoj te qendra e votimit dhe të hedh votën pasi të kem vendosur një kryq në një copë letër. Më pëlqen kjo. Është çështje përjetimi. Shtypim aq shumë butona në kompjuter...

**Bugajski:** Dhe ne lexojmë ende libra në vend të *Kindle*.

**Wollfarth:** Po. Dhe s'kam frikë ta them këtë. Më pëlqen shfletimi, ndonjëherë edhe aroma e një libri të vjetër. Kjo është jeta e vërtetë.

**Bugajski:** Po, ashtu është.

**Bugajski:** Sa u përket specifikave, mendoj se i trajtuam, por kam dëgjuar se disa anëtarë të opozitës akuzojnë se misioni është tepër i butë me qeverinë ose, me fjalë të tjera, nuk është shumë kritik ndaj rolit të qeverisë, jo vetëm në procesin zgjedhor, por edhe në procesin e demokratizimit apo mungesës së tij. A ka njëanshmëri politike në misionin e OSBE-së?

**Wollfarth:** Ne jemi këtu për të ndihmuar institucionet shqiptare, dhe këtu hyn parlamenti, qeveria, sistemi gjyqësor, policia, duke u ofruar këshilla. Gjithashtu, ata janë të parët të cilëve u drejtohem dhe kjo është pjesë e mandatit tonë. Ne nuk jemi instrument i askujt. Kudo në spektrin politik, e di se ekzistojnë disa perceptime, që ne i shohim, i dëgjojmë dhe i lexojmë, që janë të ndryshme, por nuk është kështu. Ndonjëherë kritikohemi nga të dyja palët, më shpesh gjatë zgjedhjeve, kur u kujtojmë njerëzve që të qëndrojnë në rrugën e duhur të ligjit, të ligjit shqiptar, sepse mund të jetë e parehatshme për lëvizjet teknike në momente të caktuara. Kur e bëjmë këtë, sulmohemi nga të dyja palët.

**Bugajski:** Atëherë, meqë Shqipëria është edhe anëtare e OSBE-së, a nuk përpiqet qeveria që t'ju influencojë në ndonjë lloj mënyre kur ju jep mandatin për të operuar në vend? Nuk e kam fjalën vetëm për Shqipërinë, por për çdo vend.

**Wollfarth:** Ne kemi marrëdhënie shumë të mira me qeverinë, por pika jonë kryesore e kontaktit është Ministria e Punëve të Jashtme. Ne, tradicionalisht, kemi pasur marrëdhënie të shkëlqyera me të. Ajo është mendjehapur, nuk ndërhy, dhe mua kjo gjë më duket fantastike, pasi jo të gjitha këshillat tona janë të lehta. Ne bëjmë edhe kritika. Gjithsesi, si vend pritës, Shqipëria është treguar vërtet fantastike dhe ne përpiqemi t'ia shpërblejmë duke u përpjekur që ta përdorim potencialin e jashtëzakonshëm që ka Shqipëria. Këtu ka njerëz të mirë, por i duhet mëshuar më shumë të qenit konstruktiv dhe stabilizimit të institucioneve demokratike.

**Bugajski:** Nga një këndvështrim më i gjerë, përtej zgjedhjeve, që ju e përmendët pak, a jeni dakord me disa vëzhgues që thonë se shqiptarët po shohin një dobësim të institucioneve shtetërore, moszbatim të plotë të ligjit? A ka regres apo progres të demokracisë, po ta shohim nga një këndvështrim shumë më i gjerë? Madje disa thonë se në Shqipëri ekziston një autoritarizëm në rritje. Çfarë do të thoshit ju?

**Wollfarth:** Një element i rëndësishëm në listën e pyetjeve tuaja është shërbimi civil profesional i bazuar te meritat. Gjithçka, përfshirë edhe projektligjet në këtë fushë, jo vetëm duhen miratuar, por edhe zbatuar plotësisht. Thënë kjo, dua të kujtoj se edhe pse ka nëpunës profesionistë, niveli i profesionalizmit mund të rritet me plotësimin e vendeve që nuk i mbajnë njerëzit më të zotë. Gjithmonë duke pasur parasysh buxhetin e shtetit, çfarë mund të përballojë Shqipëria dhe të bëjë më të mirën me njerëz vërtet profesionistë. Kjo do të ndihmonte jashtëzakonisht. Ka, në fakt, njerëz shumë profesionistë, nëpunës civilë shumë të mirë, prandaj do t'i ftoja qytetarët që të mos i nënvlerësojnë këto elemente. Shoh potencial për një progres të madh në këtë drejtim.

**Bugajski:** Dhe një shërbim civil i mbështetur te merita, jo një sistem që e quajmë ndryshe 'sistem i të përkëdhelurve', ku kushdo që fiton merr në punë njerëzit e vet.

**Wollfarth:** Ndonjëherë duket sikur kjo është traditë kur ka ndryshim. Shumë njerëz largohen dhe kjo, në mos humbje ekspertize, është humbje përvojë. Krijimi i kësaj përvojë është shumë i rëndësishëm. Shqipëria si vend është i hershëm, me tradita, i bukur dhe simpatik dhe vërtet më pëlqen. Por 20 vjet demokraci, me gjithë këto ndryshime që sheh në administratë, në shumë nivele, ku nuk është e nevojshme, tregojnë se nuk është mbledhur përvojë e mjaftueshme për të dhënë maksimumin dhe për t'u ofruar një shërbim të mirë qytetarëve.

**Bugajski:** Unë shoh shumë frustrim sidomos mes të rinjve, të cilëve u thuhet "Shihni, ku ka qenë Shqipëria para 20 vjetësh, shikoni se sa progres kemi bërë!", por kjo nuk i mjafton dikujt që mund të ketë parë se si funksionon pjesa tjetër e Evropës apo e Amerikës. Ata janë të paduruar. Çfarë mesazhi do të kishit për këta votues të rinj?

**Wollfarth:** Shqipëria nuk duhet të rrijë në vend, sepse i gjithë rajoni po lëviz. Sa i përket integritetit, Kroacia do t'i bashkohet Bashkimit Evropian më 1 korrik, pra pas disa javësh; Mali i Zi po bën përpara, Serbia po bën përpara, të tjera vende po ecin. Pse duhet që Shqipëria të mbetet pas? Kjo është edhe konkurrencë. Shqipëria duhet të jetë, para së gjithash, tërheqëse për sa më shumë shqiptarë që të jetë e mundur dhe kjo vjen me shtetin e së drejtës, me cilësinë e jetës, me punësimin, me gjithë këto gjëra të komplikuar. Këto nuk janë detyra të lehta, unë nuk ushqej iluzione e madje asnjë politikan nuk ushqen iluzione për këtë, dhe njerëzit duhet të dinë se duhet durim, megjithëse disa hapa mund të merren që tani.

**Bugajski:** Ndonjëherë padurimi është gjë e mirë...

**Wollfarth:** Padurimi konstruktiv është një forcë shtytëse. Mos harroni madje se edhe gjëra që ndonjëherë kanë një imazh negativ, si për shembull zilia, mund të kenë edhe pjesën e tyre konstruktive, kur e përdor si amerikanët. Fqinji ka makinë të mirë, edhe ti do që të kesh makinë të mirë dhe punon për këtë.

**Bugajski:** Jo të shkosh e t'i prishësh makinën fqinjit!

**Wollfarth:** Pikërisht!

**Bugajski:** Kam dëgjuar kudo në Ballkan rreth kësaj tradite barazimtare destruktive: nëse ti ke diçka që unë nuk e kam, unë, në vend që të konkurroj e ta kem të njëjtën gjë, shkatërroj atë që ke ti.

**Wollfarth:** Pikërisht, Janusz! Të qenit konstruktiv, kjo është ajo që ka rëndësi.

**Bugajski:** Më lejoni t'ju bëj një pyetje disi kontroverse. Siç e thatë ka pasur disa mangësi në procesin e demokratizimit të Shqipërisë. OSBE-ja ka qenë këtu për rreth 20 vjet tanimë. A merr përsipër OSBE-ja ndonjë përgjegjësi për faktin që Shqipëria nuk ka ecur më shpejt në procesin e demokratizimit? Ndoshta nuk është fare kontroverse.

**Wollfarth:** Ndoshta nuk kemi qenë shtrëngues sa duhet gjatë viteve. Por, në fund të fundit, është një parim vullnetar. Ne nuk kemi ardhur me kamzhik. Ne ndihmojmë. Veprat dhe përgjegjësia, në çdo kohë, u takojnë institucioneve shqiptare, qeverisë, parlamentit dhe gjithë institucioneve të tjera. Pra, ne ndihmojmë, nuk drejtojmë. Asnjë prej ndërkombëtarëve nuk është këtu për të bërë diçka të tillë. Sa për shembull, nuk duhet të na ngatërroi me UNMIK-un apo diçka të ngjashme. Ne kemi rol ndihmues. Dhe na është bërë ftesë për këtë rol ndihmues, kemi mandatin. Prandaj kam privilegjin të jap këshilla dhe të shpreh shqetësimet e mia me një qëllim të vetëm: të ndihmojmë Shqipërinë të ecë përpara; jo drejtpërsëdrejti, por përmes sistemit, duke ndihmuar që ta stabilizojmë dhe ta bëjmë sistemin edhe më shumë të bazuar në shtetin ligjor dhe të shohim një funksionim më të mirë të institucioneve demokratike, nisur nga parlamenti, sa për të përmendur vetëm disa prej çështjeve kryesore.

**Bugajski:** Supozoj se ekziston një lloj tensioni apo kontradikte mes pasjes së një Prezenca të gjatë të OSBE-së dhe faktin që Shqipëria është një vend i pavarur, është pjesë e NATO-s, po ecën përpara në drejtim të BE-së. Mendoni që Prezenca duhet të vazhdojë, pasi siç e thatë dhe ju, shihet si një lloj misioni mbikëqyrës, që sigurisht që nuk është. Nuk është si UNMIK-u, nuk është si misioni i NATO-s në Kosovë, etj. Por si do të ecni para tani me Prezencën e OSBE-së këtu, pas këtyre zgjedhjeve? Mendoni se duhet të vazhdojë, për sa kohë, cili duhet të jetë mandati?

**Wollfarth:** Prezenca e OSBE-së në Shqipëri duhet të vazhdojë. Mandati ynë përfshin - pa dashur ta përsëris shumë – demokratizimin, fuqizimin e institucioneve, të drejtat e njeriut, lidhur me të cilat janë shënuar arritje dhe nuk janë më aq problematike sa më parë. Është gjithmonë shteti i së drejtës në çdo aspekt. Do të thosha, dhe është edhe mendimi i shumë prej vendeve Pjesëmarrëse, siç quhen vendet anëtare të OSBE-së, që jemi në mes të mandatit tonë. Ne filluam në 1997-n, pra para 15-16 vjetësh dhe kjo nuk do të thotë që të rrimë edhe 16 vite të tjera. Varet sesa shpejt vendi ecën para. Nëse shohim arritjet, do të thosha që është përmbushur vetëm gjysma e misionit, ndaj ka arsye të mjaftueshme për të vazhduar.

**Bugajski:** Si do ta krahasonit me vendet fqinje, për sa u takon misionëve të OSBE-së? Ku keni misionë të tjera në Ballkan, përveçse në Shqipëri?

**Wollfarth:** Ne kemi misionë në Shkup, Mal të Zi, Kosovë, Serbi, në Bosnjë-Hercegovinë dhe, sigurisht, këtu në Shqipëri. Kemi pasur një mision në Zagreb, Kroaci, por për arsye të kuptueshme, tanimë që iu bashkua BE-së, u mbyll me marrjen e vendimit për datën e pranimit. Si stimul për qytetarët, kur i afroresh bashkimit nuk ka më nevojë për mision, por në rastin e Shqipërisë mbetet ende shumë për të bërë.

**Bugajski:** Që do të thotë që rruga drejt BE-së do të jetë e gjatë. Nuk do të jetë një proces 2-3-vjeçar, por shumë më i gjatë i hyrjes në BE.

**Wollfarth:** Përvoja me procese të tjera të aderimit tregon që ky është një proces që zgjat disa vjet.

**Bugajski:** Ka një çështje tjetër këtu, e cila, nuk po flas vetëm për OSBE-në, por e kam vënë re gjatë 20 viteve të kaluara. Shqipëria doli nga izolimi ndërkombëtar, por ndonjëherë duket sikur ecën në kah të kundërt. Thënë ndryshe, ka pak si tepër marrëdhënie varësie me disa qeveri, me disa institucione. Do të thoshit që vazhdimi i Prezencës së OSBE-së, ashtu si edhe i rolit të fortë të Ambasadës Amerikane, Ambasadës së BE-së, Ambasadës Gjermane, etj., krijon një marrëdhënie jo të shëndetshme varësie, ku shqiptarët i presin t'ua zgjidhin hallet të huajt e jo politikanët dhe institucioneve e tyre?

**Wollfarth:** Vërtet, mund të kishte më shumë dialog midis forcave kyçe politike dhe, ashtu siç janë gjërat, me nevojën për një shumicë prej 60% për reformë. Kjo përfshin kryetarët e dy kampeve të mëdha. Ata duhet të jenë çelësi i zgjidhjes. Por fatkeqësisht kërkohen gjithmonë lojtarë të jashtëm dhe të gjithë në lojtarët e jashtëm jemi ndërkombëtarë. Ne nuk duhet të na thërrasin si arbitra gjatë gjithë kohës, se pastaj shihemi shpesh si arbitra të njëanshëm. Kjo nuk është e arsyeshme, nuk bazohet në fakte dhe nuk çon në zgjidhje. Zgjidhja duhet të kërkohet të kampet shqiptare. Këshilla po që mund të jepen nga jashtë. Kur vjen puna te hapat shtesë, sigurisht që mund të jesh sovran, i pavarur, por kur kërkon para nga organet ndërkombëtare, atëherë sigurisht që duhet të raportosh dhe një pjesë e sovranitetit përfundon aty. Vendimi juaj sovran është që të kërkoni para nga BERZH-i, nga FMN-ja, nga Banka Botërore e shumë të tjerë, por pastaj duhet të përmbushni kushtet dhe t'u përmbaheni angazhimeve. Është si liria: në fund të fundit, nuk është e pafundme dhe duhet t'u përmbahesh rregullave.

**Bugajski:** Gjithmonë ka rregulla. Po lidhur me pjesëmarrjen e Shqipërisë në misionë të OSBE-së dhe ODIHR-it në vende të tjera? Si është pjesëmarrja e shqiptarëve në OSBE? Sa aktive është Shqipëria si vend anëtar?

**Wollfarth:** Mund të them që delegacioni i Shqipërisë në Vjenë është shumë aktiv, jo vetëm lidhur me Prezencën në Shqipëri. Janë vërtet profesionistë. Mund të them vetëm fjalë të mira. Megjithatë është jashtë fushës sime, jam i sigurt që ata japin këshilla të mira edhe për misionet fqinje, sepse OSBE-ja bazohet në një parim të rëndësishëm dhe jo gjithmonë të lehtë: konsensusin. Konsensus mes 57 vendeve pjesëmarrëse, ku përfshihet edhe Shqipëria.

**Bugajski:** Besoj se përvoja e shqiptarëve me procesin e demokratizimit do t'u jepte përparësi në vëzhgimin e zgjedhjeve, le të themi, në vendet e Azizë Qendrore ose në disa prej ish-republikave sovjetike. Mund të thonë: “e kemi pasur këtë përvojë, mund ta ndajmë me ju”.

Pra, vetë Shqipëria mund të luajë një rol të rëndësishëm, për shkak të atij procesi demokratizimi. Gjermania, p.sh., nuk ka kaluar një proces të tillë në këtë periudhë dhe as Amerika, por Shqipëria e ka kaluar. Pra, përvoja e fituar mund të përdoret si përparësi e t'u jepet të tjerëve. Jeni dakord?

**Wollfarth:** Po. Ata shkëmbejnë informacion. Në disa raste, edhe kanë dërguar vëzhgues për zgjedhjet në vende të tjera. Pra, ky shkëmbim ndodh dhe Shqipëria jep kontribut.

**Bugajski:** Lejomëni t'ju bëj edhe një pyetje përpara se ta mbyllim. Siç ju thashë, kam punuar ose e kam ndihmuar OSBE-së në kapacitete të ndryshme ndër vite. Një ndër problemet që hasen lidhur me procesin e demokratizimit është se disa anëtarë të OSBE-së ankohen se institucioni mban anën e Perëndimit, vendeve perëndimore. E kam fjalën për Rusinë dhe disa prej aleatëve dhe fqinjëve të saj. Thënë ndryshe, Moska ankohet shpesh që OSBE-ja është e njëanshme dhe përpiket të imponojë standarde e modele perëndimore të demokracisë në shtete shumë të ndryshme. Ç'përgjigje do t'i jepnit kësaj?

**Wollfarth:** Nuk më duket një përshkrim i goditur i situatës. Liria është punë e ngatërruar. Duhet të jesh i arsimuar dhe në gjendje për ta përdorur e për ta kontrolluar. Demokracia dhe përvoja në demokraci kanë vlerën e tyre. Është më i madh numri i vendeve perëndimore që kanë përvojën si dhe mundësinë për ta përçuar këtë përvojë dhe kjo mund të krijojë këtë panoramë të shtrembëruar. Por bota, duke përfshirë e madje duke filluar nga bota evropiane, ka parë shumë ndryshime pozitive dramatike gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Këtu futet edhe Rusia, e cila jo shumë kohë më parë ishte vend kryesor në Bashkimin Sovjetik. Tani rusët mund të udhëtojnë lirshëm, ekonomia është shumë më e mirë se më parë. Kjo është e vërtetë edhe për shumë vende të tjera në atë rajon. Prapëseprapë, atë mbeten vetvetja. E them këtë në kuptim pozitiv, në kuptimin kulturor. Ka shumë qasje ndaj demokracisë dhe çdo komb ka të drejtë të gjejë qasjen më të mirë ndaj demokracisë. Për mua, përkufizimi "demokraci perëndimore" është tepër i mangët. Nga perspektiva gjermane, ne kemi Poloninë në lindje, por nuk ka rëndësi nëse quhet vend lindor apo perëndimor. Është një vend që është zhvilluar jashtëzakonisht, me traditë të pasur e me demokraci çdo ditë e më të qëndrueshme. Kjo është e mirë për ne. E njëjta gjë vlen edhe për rajonin këtu. Është mirë kur fqinjët janë të qëndrueshëm, si Shqipëria, kur Mali i Zi është i qëndrueshëm, kur Serbia është e qëndrueshme, kur Maqedonia apo si e quajnë disa FYROM-i është e qëndrueshme, kur Bosnjë-Hercegovina bëhet akoma më e qëndrueshme, etj., etj. Në këtë zonë futen edhe vende anëtare të BE-së, si Rumania dhe mund të vazhdoj, si me një qepë, ta zgjeroj rrethin. Qëndrueshmëria është shumë e rëndësishme dhe ka pasur shumë arritje, nga të cilat përfiton edhe Shqipëria. Tani është koha që demokracia këtu të bëhet akoma më e qëndrueshme, të zbatohet plotësisht shteti i së drejtës dhe të merren masat e duhura, ku përfshihet procesi i reformave.

**Bugajski:** Në thelb, ju po thoni që vendet më të qëndrueshme janë vendet demokratike. Mua më duket se, për Rusinë, vende të qëndrueshme janë vendet fqinje autoritare. Por ndoshta kjo është një zgjidhje afatshkurtër për stabilitetin dhe pjesëmarrjen e publikut.

**Wollfarth:** Po.

**Bugajski:** Faleminderit, atëherë! Lejomë t'ju bëj një pyetje të fundit, personale. Di që do të largoheni së shpejti nga Tirana, pas zgjedhjeve, për një detyrë të re nga Ministria e Jashtme gjermane. Do të mbeteni në rajon? Besoj se ekspertiza dhe njohja juaj e rajonit është me shumë vlerë si për qeverinë gjermane, edhe për vetë rajonin.

**Wollfarth:** Po, do të largohem. Edhe për mua, që jam i mësuar si diplomat me ndërrimin e posteve, është e habitshme sa shpejt kaluan këta tre vjet. Unë do të kthehem në shërbimin gjerman. Do të jem në rajon, në një kuptim shumë të gjerë të fjalës, por jo në Ballkanin Perëndimor. Kaq mund t'ju them. Kur të jem në gjendje ta them se ku do të shkoj, do të më kuptoni. Po e pres me padurim. Do të jetë një detyrë interesante.

**Bugajski:** Shumë faleminderit, sërish, për kohën që më kushtuat dhe urimet më të mira për detyrën e re, kudo qoftë. Ndoshta në të ardhmen do t'ju kemi sërish në emision. Faleminderit shumë!

**Wollfarth:** Faleminderit, Janusz, për ftesën! Ishte kënaqësi të flisja me ju.

**Bugajski:** Faleminderit!